



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**  
**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /**  
**Ministry of Culture, Youth and Sports**  
Kabineti i Ministrit  
Kabinet Ministra  
Minister's Office

Nr. 119/2021

Datë: 29.09.2021

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L – 113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 07, 01 Mars 2019), bazuar në Shtojcën 1 pika 8 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 58 të Ligjit Nr. 02/L – 59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës, mori këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Këshilli Përgatitor për iniciimin dhe funksionalizimin e institucionit të Operës së Kosovës.
2. Këshilli ka këtë përbërje:
  - 2.1. Merita Juniku,
  - 2.2. Inva Mula
  - 2.3. Dardan Selimaj,
  - 2.4. Rreze Kryeziu Breznica
  - 2.5. Besa Luzha
  - 2.6. Edon Ramadani
  - 2.7. Mehdi Uka
3. Këshilli Përgatitor është i mandatuar të kryej të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë për funksionalizimin e institucionit të Operës së Kosovës duke përfshirë:
  - 3.1. Konceptimin/Hartimin e organogramit të brendshëm, me specifikat e burimeve njerëzore të Institucionit të Operës së Kosovës;
  - 3.2. Përgatitjet e nevojshme në konceptim/hartim të akteve nënligjore të nevojshme për punë;
  - 3.3. Përgatitjet e nevojshme për krijimin e kushteve adekuate infrastrukturore për punë;
  - 3.4. Konceptimin/Hartimin e planit vjetor të punës, duke përfshirë programin artistik vjetor;
  - 3.5. Përgatitjet e tjera administrative dhe teknike mbështetëse të nevojshme për funksionim;

3.6.Parashtron kërkesat dhe mbikqyrë procesin e pranimit të stafit bazik në punë në kuadër të institucionit;

4. Emërimi i këtij këshilli është me mandat të përkohshëm i cili detyrën e tij e ushtron deri në momentin e krijimit të kushteve adekuate duke përfshirë edhe krijimin e kushteve ligjore për funksionalizim të institucionit të Operës së Kosovës në përputhje me Ligjin Nr. 02/L – 59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës ;
5. Anëtarët e Këshillit Drejtues, kompensohen financiarisht në vlerë prej 125.00 (njëqind e njëzet e pesë) euro për kryetarin, ndërsa 100.00 (njëqind) euro për anëtarët e këshillit, për më së shumti 2 mbledhje në muaj.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

*Vendimi i dërgohet:  
Kabinetit të Ministrit;  
Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;  
Departamentit të Kulturës;  
Departamentit Ligjor  
Arkivit të MKRS – së;*

